



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Udhëzim i Zyrës Administrative

Kufizime të përgjithshme mbi vizitat për shkak të kovid-19

Miratuar nga:	Administratorja, Dhoma e Specializuarë të Kosovës
Data e miratimit:	23 shtator 2020
Data e hyrjes në fuqi:	23 shtator 2020
Zëvendëson:	Nuk ka
Numri:	KSC-BD-35

Përmbajtja

KREU I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
PJESA 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
PJESA 2	PARIMET	2
PJESA 3	GJUHA AUTENTIKE DHE HYRJA NË FUQI	3
KREU II	KUFIZIMET PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT	3
PJESA 4	KUFIZIME TË PËRGJITHSHME TË VIZITAVE PERSONALE PREJ ANËTARËVE TË FAMILJES DHE TË VIZITAVE TË TJERA PERSONALE NË OP	3
PJESA 5	KUFIZIME TË PËRGJITHSHME TË NUMRIT TË VIZITORËVE DHE SENDEVE QË SILLEN GJATË VIZITAVE ME MBROJTËSIT	3
PJESA 6	RISHIKIMI	4

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim është nxjerrë nga Administratorja në përputhje me rregullën 4.2 të Rregullores së Paraburgimit për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve që mbahen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ('OP') në burgun holandez PI Haaglanden ('burgu'), si dhe të shëndetit të oficerëve të paraburgimit dhe punonjësve të tjerë në OP.
2. Ky Udhëzim ka për qëllim vendosjen e kufizimeve të përkohshme dhe proporcionale mbi vizitat personale në OP, në përputhje me këshillat e mjekut të njësisë së paraburgimit, të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të personave të tjerë dhe për parandalimin e përhapjes së koronavirusit të ri (kovid-19) në OP.
3. Pjesa 4 e këtij Udhëzimi zbatohet për vizitat midis të paraburgosurve dhe anëtarëve të familjes dhe personave të tjerë përcaktuar në Udhëzuesin e Punës për Vizitat dhe Komunikimet të miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit.
4. Pjesa 5 e këtij Udhëzimi zbatohet për vizitat e mbrojtësve përcaktuar në Udhëzuesin e Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve të miratuar në bazë të rregullës 63 të Rregullores së Paraburgimit.
5. Ky Udhëzim interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Rregulloren e Paraburgimit, si edhe me udhëzuesit e punës dhe udhëzimet e miratuara ose të nxjerra në përputhje me rregullën 4 të Rregullores së Paraburgimit.

Pjesa 2 Parimet

1. Ky Udhëzim është i përkohshëm dhe shfuqizohet me anë të një udhëzimi tjetër të Administratores, që lëshohet kur kufizimet nuk janë më të domosdoshme dhe proporcionale.
2. Administratorja mund të ndryshojë këtë Udhëzim *proprio motu* ose me këshillë të shefit të paraburgimit, pas konsultimeve me mjekun e njësisë së paraburgimit.
3. Të paraburgosurit informohen për këtë Udhëzim si dhe për ndryshimin ose shfuqizimin e tij.

Pjesa 3 Gjuha autentike dhe hyrja në fuqi

1. Gjuha autentike e këtij Udhëzimi është anglishtja.
2. Ky Udhëzim dhe çdo ndryshim ose shfuqizim i tij hyjnë në fuqi në datën e miratimit të tyre.

KREU II KUFIZIMET PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT

Pjesa 4 Kufizime të përgjithshme të vizitave personale prej anëtarëve të familjes dhe të vizitave të tjera personale në OP

1. Për të mbrojtur shëndetin e të paraburgosurve dhe personave të tjerë me anë të kufizimit të kontakteve personale, vizitat në OP kufizohen përkohësisht për të gjithë të paraburgosurit, në përputhje me nenet 4.2 dhe 6.1. të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet. Të paraburgosurve nuk u lejohen vizita personale në OP, përfshirë vizitat private.
2. Në vend të vizitave personale në OP, lejohen vizita përmes videolidhjes në përputhje me Udhëzimin e Zyrës Administrative për Vizitat përmes Videolidhjes miratuar në bazë të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit.
3. Pavarësisht nga neni 16 i Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet, shpenzimet e thirrjeve telefonike dalëse mbulohen përkohësisht prej Dhomave të Specializuara.
4. Paragrafët 1-3 të kësaj pjese mbeten në fuqi deri në ndryshimin e mundshëm ose shfuqizimin e këtij Udhëzimi në përputhje me pjesën 2 më lart.

Pjesa 5 Kufizime të përgjithshme të numrit të vizitorëve dhe sendeve që sillen gjatë vizitave me mbrojtësit

1. Për të mbrojtur shëndetin e të paraburgosurve dhe personave të tjerë me anë të kufizimit të kontakteve personale, dhe në pajtim me nenin 14.1 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve, në vizitë personale me mbrojtësin në OP nuk lejohet të jenë të pranishëm më shumë se dy (2) vizitorë në të njëjtën kohë.
2. Gjithashtu lejohen vizita me mbrojtësit përmes videolidhjes, në përputhje me Udhëzimin e Zyrës Administrative për Vizitat përmes Videolidhjes miratuar në bazë të rregullës 4 të Rregullores së Paraburgimit.
3. Për të mbrojtur shëndetin e të paraburgosurve dhe personave të tjerë nga përhapja e virusit kovid-19 përmes kontaktit me dërgesa ose sipërfaqe të tjera, sjellja e sendeve në OP gjatë vizitave me mbrojtësit kufizohet në përputhje me nenet 11.3 dhe 14.1 të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet e Mbrojtësve. Gjatë vizitave të tyre, mbrojtësit nuk shkëmbejnë dokumente fizike drejtpërsëdrejti me të paraburgosurit dhe nuk sjellin me vete kompjuterët e tyre të bartshëm (laptop).
4. Në vend të kësaj, mbrojtësit mund të shkëmbejnë me të paraburgosurit dokumente fizike dhe sende të tjera të autorizuara duke ndjekur procedurën e sjelljes dhe nxjerrjes së sendeve të përcaktuar në Udhëzimin e Njësisë së Paraburgimit mbi Rregulloren e Brendshme të Objektivit të Paraburgimit.
5. Paragrafët 1-3 të kësaj pjese mbeten në fuqi deri në ndryshimin ose shfuqizimin e këtij Udhëzimi në përputhje me pjesën 2 më lart.

Pjesa 6 Rishikimi

Të paraburgosurit të cilëve u janë kufizuar vizitat në bazë të këtij Udhëzimi mund t'i paraqesin autoritetit përkatës ankesë ose kërkesë zyrtare për rishikim, sikurse përcaktohet me hollësi në Udhëzuesin e Punës për Ankesat miratuar në përputhje me rregullën 63 të Rregullores së Paraburgimit.

Hagë, Holandë.
23 shtator 2020

Dr. Fidelma Donlon
Administratore